

V E N D I M
Nr. 59, datë 5.11.1999

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga :

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Hilmi Dakli,	Anëtar i	“““
Hajredin Fuga,	Anëtar i	“““
Zija Vuci,	Anëtar i	“““
Alfred Karamuço,	Anëtar i	“““
Kristofor Peçi,	Anëtar i	“““
Sokol Sadushi,	Anëtar i	“““
Kujtim Puto,	Anëtar i	“““

Me sekretare Noela Ruço, më datë 13.10.1999, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura kërkesën me nr.54 Akti që i përket :

K Ë R K U E S E: GJYKATA E LARTË E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË.

SUBJEKTE TE INTERESUARA:

1. KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, në mungesë.
2. KËSHILLI I MINISTRAVE, i përfaqësuar nga zoti Sokol Çomo, zëvendësministër i Drejtësisë
3. KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË, në mungesë.
4. ALI PAJA, i përfaqësuar nga avokat Maksim Haxhia.

O B J E K T I:

Shfuqizimin si antikushtetues të nenit 48 të ligjit nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. Baza ligjore: Neni 145/2, 147/6 të Kushtetutës

GJYKATA KUSHTETUESE, pasi dëgjoi shpjegimet e përfaqësuesve të subjekteve të interesuara dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin nr.585, datë 14.7.1999, kanë pranuar kërkesën e përfaqësuesit të kërkuarit Ali Paja dhe sipas nenit 145/2 të Kushtetutës kanë pezulluar gjykimin e çështjes për ta dërguar në Gjykatën Kushtetuese. Në vendimin e mësipërm Kolegjet e Bashkuara çmojnë se neni 48 i ligjit nr.8436, datë 25.5.1999 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” vjen në kundërshtim me nenin 147/6 të Kushtetutës. Sipas Vendimit të Kolegjeve të Bashkuara, megjithëse provimi i kualifikimit profesional ka të bëjë me verifikimin e “mjaftueshmërisë apo pamjaftueshmërisë profesionale” “kemi tejkalim të rasteve të parashikuara në Kushtetutë për shkarkim nga detyra të gjyqtarit, kur bëhet fjalë për mosmarrje të provimit”. Po sipas këtij vendimi, caktimi i afatit deri 10 vjet punë për të dhënë ose jo provim sjell diferencim në të drejta midis gjyqtarëve. Së fundi, Kolegjet e Bashkuara kanë çmuar se neni 48 si dispozitë kalimtare e ligjit të lartpërmendur vjen në kundërshtim me kërkesat e nenit 45 që rregullon vlerësimin e aftësisë profesionale të gjyqtarëve.

Gjykata Kushtetuese konstaton se neni 48/1 i ligjit nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” që përcakton detyrimin e gjyqtarëve të shkallës së parë me përvojë deri në 10 vjet t’i nënshtrohen një provimi kualifikimi profesional, nuk ka përmbajtje antikushtetuese.

Si Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ashtu edhe aktet ndërkombëtare, siç është ai i Parimeve Themelore lidhur me Pavarësinë e Organeve Gjyqësore, pranojnë nevojën e gjyqtarëve të kualifikuar duke parashikuar edhe shkarkimin e tyre kur konstatohet pamjaftueshmëri profesionale.

Organizimi i provimit, siç del nga vetë paragrafi i parë i nenit 48 të ligjit, bëhet me qëllim kualifikimi profesional pra për të rritur nivelin e gjyqtarëve dhe për ta azhurnuar me kërkesat e kohës

në fushën juridike. Në Shqipëri, në rrethanat kur gjatë viteve 1991-1998 e në vazhdim legjislacioni i vjetër u përmbys e në vend të tij janë miratuar Kushtetuta e Kodet, të cilat përmbajnë shumë parime e norma të reja dhe në realitetin kur niveli profesional i gjyqimit ka mangësi serioze, është domosdoshmëri që kualifikimi profesional i gjyqtarëve të përparojë së bashku me legjislacionin. Prandaj vlerësimi i dijeve të tyre në rrethanat e reja të jetës e për Kodet e reja, nuk mund të interpretohet se ve në dyshim diplomën e fakultetit dhe as cënon autonominë e institucioneve të arsimit të lartë në kuptim të nenit 57/7 të Kushtetutës. Përkundrazi nëpërmjet përgatitjes profesionale sigurohet më mirë zbatimi i parimit kushtetues të pavarësisë së gjyqtarëve dhe të nënshtrimit të tyre vetëm Kushtetutës e ligjeve. (Neni 145/1 i Kushtetutës) Ky qëndrim është mbajtur edhe më parë me Vendimin nr.6, datë 10.7.1995 të Gjykatës Kushtetuese.

Format për kualifikimin profesional janë nga më të larmishmet dhe një prej tyre është edhe organizimi i provimit, i cili shërben si nxitje për gjyqtarët për studim, por në të njëjtën kohë shërben edhe si një mjet për të vlerësuar shkallën e dijeve të gjithësecilit, në kuadrin e përgjithshëm të vlerësimit profesional.

Në këtë aspekt, pjesëmarrja në provim përbën një detyrë ligjore që secili gjyqtar sipas kritereve të përcaktuara nga ligji, duhet t'i nënshtrohet këtij provimi. Nëse duhet zbatuar ose jo ky detyrim nuk është lënë në vlerësimin e gjyqtarëve, ndërsa përgjegjësia për mospërmbylljen e këtij detyrimi, është individuale dhe çmohet në çdo rast konkret në varësi të shkaqeve që pretendon gjithësecili.

Detyrimi i gjyqtarëve që kanë përvojë pune deri në 10 vjet, për të dhënë provim, pra caktimi i afatit në ligj, nuk ka të bëjë me antikushtetutshmërinë, por me të drejtën e ligjvënësit të caktoj kualifikimin e nevojshëm profesional dhe kategoritë e punonjësve që do t'i nënshtrohen këtij lloji kualifikimi. Ai nuk sjell diferencim të drejtash kushtetuese sepse provimi nuk organizohet për të cënuar këto të drejta, por për kualifikimin e gjyqtarëve dhe kjo është në përputhje me përmbajtjen e Kushtetutës.

Paragrafi i tretë i nenit 48 që sanksionon se: "... gjyqtarët që nuk kalojnë provimin shkarkohen nga detyra me Vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë...", ka të bëjë vetëm me ata gjyqtarë që janë futur në provim dhe që nuk kanë marrë numurin e nevojshëm të pikëve.

Në ligjin nr.8436, datë 28.12.1998 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", janë përcaktuar jo vetëm rregullat e vlerësimit të aftësisë ose paaftësisë profesionale, por edhe treguesit e tij: cilësia, volumi i punës, shpejtësia e gjyqimit, reputacioni, botimi i punimeve juridike apo marrja e provimit të kualifikimit profesional. Duke u nisur nga përmbajtja e këtij ligji dhe sidomos e nenit 147/6 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundim se pamjaftueshmëria profesionale është koncept më i gjerë se mosmarrja e një provimi. Ky i fundit nuk mund të jetë tregues i vetëm sintetik i vlerësimit të aftësisë profesionale të gjyqtarit. Vetë neni 45 i ligjit në fjalë që trajton në mënyrë të detajuar vlerësimin e aftësisë profesionale, e lidh këtë të fundit me disa tregues, që u përmendën më lart. Këto dhe fakti që provimi ka edhe vështirësitë e veta, anën emotive e psikologjike dhe kërkon kohën e nevojshme në dispozicion etj., del se mosmarrja e provimit duhet vlerësuar krahas treguesve të tjerë të nenit 45 të ligjit nr.8436, datë 28.12.1998. Vlerësimi vetëm i rezultatit të provimit pa marrë parasysh rezultatet në punë të gjyqtarit dhe kontributin e tij teorik e praktik në fushën juridike, është një qëndrim antikushtetues që del tej përmbajtjes së Kushtetutës. Si rrjedhojë paragrafit i tretë i nenit 48 të këtij ligji ku thuhet se: "Pavarësisht nga përcaktimi i nenit 27 të këtij ligji, gjyqtarët që nuk e kalojnë provimin, shkarkohen nga detyra me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë", duhet shfuqizuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/a, 134/d në lidhje me nenin 145/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 41 të ligjit nr.8373, datë 15.7.1998 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

V E N D O S I:

Shfuqizimin si antikushtetues të paragrafit të tretë të nenit 48 të ligjit nr.8436, datë 28.12.1998 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë".

Rrëzimin e kërkesës për pjesët e tjera.
Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren
Zyrtare.

Tiranë, më 5.11.1999
Nr. 54 i regjistrimit themeltar
Nr. 59 i vendimit